



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. Unit	SP-02	Nr i Prot. Prot. No	5597-2/24
Nr i Faqeve No Pages	06	Data Date	26.03.25
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.03.2025
REFERENC-Ë:	24/5597/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë" Sh.A., Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 24/5597/593/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë" Sh.A., Prishtinë - për zgjerimin e Deponisë së mbeturinave në Velekincë dhe Uglar komuna e Gjilanit.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë" Sh.A., Prishtinë – pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për zgjerimin e Deponisë së mbeturinave në ngastrat kadastrale me Nr. P-70403006-00754-0, P-70403006-00004-0, P-70403006-00003-0, P-70403006-00779-1, P-70403006-00779-2, P-70403006-00778-0, P-70403006-00771-0, P-70403006-00770-0, P-70403006-00764-0, P-70403006-00763-0, P-70403006-00755-1, P-70403006-00755-2, P-70403006-00731-1, P-70403006-00731-2, P-

Faqe 2 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks.gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks.gov.net



70403006-00732-0 në ZK Velekincë dhe P-70403061-01744-0 në ZK Uglar komuna e Gjilanit nën kushtet si vijon:

Gjatë fazës së ndërtimit:

- Gjatë fazës së Ndërtimit të zgjerimit të Deponisë së mbeturinave në Velekincë dhe Uglar komuna e Gjilanit të respektohen normat e shkarkimeve në ajër nga makineritë dhe pajisjet e rënda të ndërtimit, automjetet me të cilat transportohen pajisjet e nevojshme po ashtu edhe të kontrollohet niveli i zhurmës dhe sasia e pluhurit që krijohen si pasojë e qarkullimit të automjeteve të rënda;
- Minimizimi i pluhurit nga vendgrumbullimi i materialeve, duke përdorur mbulesa dhe/ose pajisje kontrolli, duke mbuluar hapësirën e magazinimit;
- Minimizimi i pluhurit në rrugët e transportit duke i spërkatur vazhdimisht me ujë;
- Gjendja infrastrukturore jashtë lokacionit të Deponisë e cila përdoret gjatë fazës së ndërtimit (infrastruktura rrugore, etj.) duhet të mirëmbahet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të fazës së ndërtimit;

- Administrimi i mbeturinave

- Administrimi i mbeturinave në deponi magazinimi dhe deponimi, duhet të bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina;
- Me kushtet e përcaktuara në vendimin e pëlqimit mjedisor operatori detyrohet që pas ndërprerjes përfundimtare të zgjerimit të Deponisë së mbeturinave në Velekincë dhe Uglar komuna e Gjilanit të planifikoi masat për rehabilitimin e vendndodhjes së tij;
- Ndërtimi i zonave shtesë të zgjerimit të Deponisë së mbeturinave në Velekincë dhe Uglar komuna e Gjilanit, duhet të i plotësoi kushtet e parapara në Raportin e VNM-së, për të plotësuar kushtet mjedisore të parapara me Legjislacionin në fuqi,
- Të mirren masat për zvogëlimin e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit dhe pas fazës së ndërtimit.
- Të ndërtohen kanalet e sistemit të grumbullimit dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore dhe ujërat e kullimit brenda deponisë;
- Të vendosen gypat për grumbullimin e gazrave
- Të ndërtohet rrjeti i drenazhimit si dhe impianti për trajtimin e kullimit
- Të ndërtohen pusët monitoruese të ujërave nëntokësore



- Te behet thurja fizike e deponisë për pengimin e hyrjes së personave të pa autorizuar.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (revohohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë" Sh.A., Prishtinë - për zgjerimin e Deponisë së mbeturinave në ngastrat kadastrale me Nr. P-70403006-00754-0, P-70403006-00004-0, P-70403006-00003-0, P-70403006-00779-1, P-70403006-00779-2, P-70403006-00778-0, P-70403006-00771-0, P-70403006-00770-0, P-70403006-00764-0, P-70403006-00763-0, P-70403006-00755-1, P-70403006-00755-2, P-70403006-00731-1, P-70403006-00731-2, P-70403006-00732-0 në ZK Velekincë dhe P-70403061-01744-0 në ZK Uglar komuna e Gjilanit, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrotjtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore të Integruar

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Faqe 4 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/5597/1 - ZSP/ /25 datë: 03.03.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Komunës së Gjilanit
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivoit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

